



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 paragrafi 2 nenin 8, nenin 9 paragrafi 1, nenin 18 të Ligjit ne. 04/L-212 për Financimin e Subjekteve Politike, nenin 1 paragrafi 2, nenin 5 dhe nenin 6 paragrafi 2 të Rregullës nr.14/13, Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, si dhe bazuar në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1233/2017 të datës 08.07.2017 për Certifikimin Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Pratikshme për Kuvendin e Kosovës të 11 Qershorit 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datën 28.03.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për Vitin 2019

- I. Caktohet lartësia e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për financimin e aktiviteteve të rregullta, të subjekteve politike të Certifikuara nga KQZ me vendimin nr.1233/2017 të datës 08.07.2017 për Certifikimin Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Pratikshme për Kuvendin e Kosovës të 11 Qershorit 2017, të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat.
- II. Shuma e mjeteve për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike nga Fondi për vitin 2019 është **4,200,000,00€** dhe ndarja bëhet si në pikën I të këtij vendimi në bazë numërimit të ulëseve të fituara për Kuvend për atë mandat për subjektet politike si në vijim:

Nr.	Akronimi	Subjekte Politike	Nr. i Ulëseve	Shuma për subjektet politike	Shuma për grupet parlamentare
1		PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS-NISMA PËR KOSOVËN-PARTIA E DREJTËSISË-LËVIZJA PËR BASHKIM-PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS-ALTERNATIVA DEMOKRATIKE E KOSOVËS-REPUBLIKANËT E KOSOVËS-PARTIA E BALLIT-	39	1,228,500.00	136,500.00

		PARTIA SOCIALDEMOKRATE-BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS			
2		LËVIZJA VETËVENDOSJE!	32	1,008,000.00	112,000.00
3	LDK-AKR	LIDHJA DEMOKATIKE E KOSOVËS-ALEANCA KOSOVA E RE	29	913,500.00	101,500.00
4		SRPSKA LISTA	9	283,500.00	31,500.00
5	KDTP	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	2	63,000.00	7,000.00
6	KOALICIJA VAKAT	KOALICIJA VAKAT	2	63,000.00	7,000.00
7	NDS	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	1	31,500.00	3,500.00
8	SLS	SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA	1	31,500.00	3,500.00
9	PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	1	31,500.00	3,500.00
10	PLE	PARTIA LIBERALE EGJPTIANE	1	31,500.00	3,500.00
11	JGP	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1	31,500.00	3,500.00
12	PAI	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	1	31,500.00	3,500.00
13	PREBK	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	1	31,500.00	3,500.00
Totali			120	3,780,000.00	420,000.00

- III. Për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet, subjekti politik ndanë mjetet nga Fondi në pajtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.
- IV. Mjetet nga pika II e këtij vendimi subjekteve politike u ndahen nga Fondi për mbështetje subjekteve politike.
- V. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, për zbatimin e këtij vendimi
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

